

22-03-2021

Ref. 2103/366/BA/yf



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr.10/2021

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2103/285/BA/yf të datës 08.03.2021 të parashtruesit “Grupi Koha” SH.P.K të përfaqësuar nga avokatet Arianit Koci dhe Granit Vokshi, me adresë në rrugën Robert Dollli Nr. 34, Prishtinë kundër Vendimit me numër Ref:2102/169/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datë 12.03.2021 mori këtë:

V E N D I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar Ankesa e “Grupi Koha SH.P.K”- KTV me numër Ref:2103/285/BA/yf e datës 08.03.2021 kundër Vendimit të Komisionit të Pavarur të Mediave me numër Ref:2102/169/KPM/xh.l i datës 11.02.2021 vetëm sa i përket shqiptimit të gjobës nga shuma pesë mijë (5000) euro, të zbritet në shumën katër mijë (4000) euro, ndërsa pjesa tjetër e Vendimit mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/169/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 i ka shqiptuar gjobë “Grupi Koha” SH.P.K-KTV në shumën pesë mijë (5000) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 për shkelje të nenit 49 paragrafit 6 të Ligjit Nr.033/L-037 për zgjedhje në Republikën e Kosovës.

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “Grupi Koha SH.P.K” përfaqësuar nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi, me adresë në rrugën Robert Dollli, nr.34, ka parashtruar Ankesë Ref:2103/285/BA/yf të datës 08.03.2021 pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim i gabuar i së drejtës materiale dhe kërkon që të aprovet nga BA Ankesa si e bazuar dhe të anulohet Vendimi i lartcekur i KPM-së.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Grupi Koha SH.P.K”, si dhe ka analizuar të gjitha provat

tjera që gjenden në shkresat e lëndës më të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref:2102/169/KPM/xhl, të datës 11.02.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike duke u bazuar në dispozitat materiale dhe procedurale që e rregullojnë fushën e Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa edhe përkundër shkeljes së Palës ankuese në bazë të Vendimit kontestues, për zvogëlimin e gjobës si në dispozitivin e këtij vendimi ka vendosur për shkak të krizës financiare globale si pasojë e Covid 19, e cila krizë ka ndikuar edhe në fushën e mediave.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 i Rregullores Nr. BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi mund të nicoshet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Palëve dhe
- Arkivit të KPM-së.



Ylber Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa